



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.593/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për deputete nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, Floriana Rugova, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Obiliq, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

Hedhet e pa lejuar ankesa Anr.593/2025, e datës 16.02.2025, e parashtruar nga kandidatja për deputete nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, Floriana Rugova, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Obiliq, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesën A.nr.593/2025, të datës 16.02.2025 në të cilën ka theksuar se, unë kam dilemat e mia që kanë të bëjnë me numërimin e votave në Qendrat Komunale në Komunën e Obiliqit, me datë 14.02.2025 kur ka përfunduar numërimi nga votat që kam menduar me i marrë nuk më janë përputhë me familjarë dhe miqtë që kemi diskutuar. Andaj, parashtruesja e ankesës ka kërkuar ri-numërimin e votave përsëri, me kërkesë të veçantë Vendvotimi 1504/02, 1512/01.

Si provë parashtruesja e ankesës ka bashkangjitur vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ, për çerifikimin e subjektit politik PDK me 110 kandidatë në listë dhe listën me 110 kandidatë të subjektit në fjalë.

Në përgjigje në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve KQZ, ka theksuar se së pari ankuesja në ankesë ka theksuar se zgjedhjet janë mbajtur më 14 shkurt 2025, kjo nuk qëndron sepse zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, janë mbajtur më 09 shkurt 2025. Gjithashtu pretendimet janë të pa bazuara, sepse ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, nuk ka mundur të konstatoj se ka pasur manipulim të votave, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në ndonjë provë konkrete por janë supozime, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit dhe mungesë të votave.

Tutje në përgjigje në ankesë ka theksuar se KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Obiliqit, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: KKZ, e komunës së Obiliqit, ka njoftuar KQZ, lidhur me ankesën e palës ankuese, si në vijim: “Sa i përket procesit zgjedhor në komunën e Obiliqit nga dita e zgjedhjeve dhe deri te numërimi i votave së fundit nga ekipet e numërimit gjithçka ka qenë në rregull. Procesi i numërimit ka filluar me 11.02.2025 dhe ka mbaruar me 14.02.2025 ky proces është vëzhguar nga vëzhguesit e partive politike po ashtu edhe nga vëzhguesit, ku nuk kemi pas as vërejtje më të vogël nga ana e tyre, sepse procesi ka qenë i rregullt dhe transparent ku çdo votë është lexuar para syrit të kamerës dhe po ashtu është shënuar para syrit të kamerës ku të gjithë ata të cilët kanë qenë prezent e kanë shikuar nëpërmjet ekranit çdo detaj të procesit të numërimit”. Më tutje sipas parashtruesit të përgjigjes në ankesë, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura në këtë përgjigje, pretendimet e palës ankuese nuk kanë asnjë bazë ligjore dhe nuk janë të mbështetura nga ndonjë provë të qartë dhe bindëse. Andaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura si më sipër, si dhe nenin 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka kërkuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) që pretendimet e palës ankuese t’i hedhë si të pabazuara.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë vëren se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohen parregullsive në ditën e votimit, për shkak se përmes ankesës atakohet rezultati i votimit, e që kanë të bëjë me numërimin e votave në Qendrat Komunale në Komunën e Obiliqit, me datë 14.02.2025, kur ka përfunduar numërimi i votave, i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, pra nuk është rezultat përfundimtar i zgjedhjeve i shpallur me vendim nga KQZ, prandaj në këto rrethana ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se në pajtim me nenin 106 par. 3 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet E Përgjithshme në Republikën e Kosovës pas shpalljes së rezultatit përfundimtar me vendim të KQZ i njëjti rezultat është i ankimeshëm nga personi fizik ose juridik të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Neni 106 par. 3 i Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet E Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet se personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrtojë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij.


Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht” dhe Nenit 13.3 të Rregullores Nr.01 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim. ”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosija sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejjudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 13.3 Rregullores Nr.01 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.593/2025, datë 18.02.2025

Kryesues i Panelit
Skender Coçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.